REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1381/2
Data / Datum / Date: 31 / 08 / 2026
Shtojca / Dodaci / Annex -2-
PRISHTINË/A (2024)

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministarke Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr.157/2026
Datë: 31.08.2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me 22 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 2) dhe nenin 25 të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin nr. 08/L-272, në mbështetje të nenit 44 dhe 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) – Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë në detyrë, nxjerr këtë:

V E N D I M
Për pushimin e shërbimit të noterit

1. Znj. Vlora (Mexhid) Haziri, e emëruar noter në territorin e Komunës së Gjakovës, me Vendimin nr. 238/2024, të datës 15.07.2024, i pushon ushtrimi i detyrës së noterit për shkak të dorëheqjes.

2. Shfuqizohet Vendimi nr. 238/2024, të datës 15.07.2024 për emërimin e znj. Vlora Haziri në detyrën e noterit dhe Vendimi nr. 102/2025 të datës 26.03.2025 për fillimin e ushtrimit të detyrës së noterit.

3. Obligohet Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika në Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën 01.09.2026.

A r s y e t i m

Me Vendimin nr. 238/2024, të datës 15.07.2024, znj. Vlora Haziri është emëruar në detyrën e noterit për territorin e Komunës së Gjakovës, ndërsa me Vendimin nr.

102/2025 të datës 26.03.2025 znj. Haziri është caktuar të filloj të ushtroj detyrën e noterit me datën 07.04.2025.

Më datë 27.08.2026, znj. Haziri, përmes një shkrese zyrtare drejtuar Ministres së Drejtësisë, ka paraqitur dorëheqjen nga ushtrimi i detyrës së noterit, duke theksuar se arsyeja e dorëheqjes është për shkaqe të shpenzimeve financiare, gjegjësisht pamundësia për të mbuluar shpenzimet me të ardhurat që krijohen nga funksionimi i zyrës noteriale, me efekt nga data 01.09.2026.

Andaj me që dorëheqja e saj është paraqitur në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, në pajtim me neni 22 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe paragrafi 2) dhe nenit 25 (paragrafi 2) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin nr. 08/L-272, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Donika Gërvalla Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë

Vendimi i'u dërgohet:

- *Znj. Vlora Haziri;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;*
- *Gjykatës Themelore në Gjakovë;*
- *Odes së Noterëve të Kosovës;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit te Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika.*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*